

Njoftim: Mundësi punësimi si Nëpunës për dhënie informacioni

Pozicioni: Nëpunës për dhënie informacioni

Kohëzgjatja: 1 vit

Orari: Kohë e Plotë

Arsimi: I lartë

Eksperienca: Minimumi 2 vjet punë në kompani të ngjashme.

Përse EasyPay?

- Ju do pëlqenit të punonit me kolegë inteligjentë, të shkathët dhe bashkëpunues mosha mesatare e të cilëve është 28 vjec;
- Do të ishit pjesë e një mjedisi dinamik pune dhe shumë emocionues;
- Do të jepnit kontributin tuaj në sektorin Financiar në Shqipëri duke qenë pjesë e kompanise më inovative e cila renditet ne Top 3 në listën e kompanive Fin-Tech më të mira në Europë.

Cilat do të jene perfitimet tuaja?

- Një eksperiencë pune e vlefshme;
- Mundësinë për të hedhur një hap në karrierën tuaj;
- Mundësinë për të zhvilluar dhe definuar aftësitë tuaja profesionale;
- Bashkëpunimi me profesionistë në këtë fushë;
- Përfitime financiare.

Kush do pershtatej më së miri me këtë detyrë?

Dikush që kembengul : Ju përballeni me gjithcka me energji dhe me egon për ta cuar deri në fund atë që ju ngarkohet, dhe rrallë braktisni pa përfunduar sidomos përballë vështirësive apo rezistencave.

Dikush që planifikon : Ju dini të përcaktoni me saktësi vështirësitë e detyrave dhe projekteve të ngarkuara. Ju keni qëllime dhe objektiva të qarta dhe dini të ndani dhe zhvilloni punën në hapa, duke parashikuar dhe regulluar pengesat.



Cilat janë detyrat kryesore që do të zhvilloni ?

- T'i përgjigjeni telefonatave dhe e-maileve që vijnë në drejtim të shërbimit të klientit;
- Merrni porositë e ndryshme nga rrjeti i agjentëve;
- Kontaktoni me klientët për problemet e ndryshme që ata reklamojnë, orientoni zgjidhjen e tyre në departamentet përkatëse;
- Kryeni njoftimet e ndryshme të klientët për ndryshimet e procedurave të punës etj;
- Mbani kontaktet me klientet;
- Monitoroni procesin e porosive dhe pagesave dhe bashkëpunoni ngushtë me gjithë departamentet;
- Monitoroni procesin e shërbimit të transfertave duke udhëzuar klientët dhe agjentët që e ofrojnë shërbimin.

Cilat janë kualifikimet që duhet të keni ?

- Diplomë në degën Ekonomi-Financë/ Informatikë Ekonomike/Administrim Biznes ose në degë të ngjashme;
- Njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Njohuri dhe eksperiencë mbi sistemin e pagesave elektronike, apo në kompani me profil të ngjashëm;
- Njohuri të mira mbi paketën Office 2010;
- Aftësi shumë të mira komunikimi, të tregoni se mendoni dhe mësoni shpejt duke treguar qetësi dhe mature;
- Fleksibilitet për të kapërcyer sfidat e përditshme dhe të jeni të mirëorganizuar në detaje;
- Aftësi të mira në priorizimin dhe menaxhimin e kohës në mënyre efektive;
- Përkushtimin e duhur në punë, përgjegjshmërinë, iniciativa për të kryer sakte detyrat individuale si dhe të jeni i gatshëm të punoni në grup.

Dokumentacioni paraprak: CV, Kopje të Certifikatave, Diplomave të kualifikimeve të ndryshme duhet të dërgohen me email në adresën: info@easypay.al.

****Do të lajmërohen për intervistë vetëm kandidatët që do të perzgjidhen të cilëve do t'u kërkohet dokumentacion shtesë.***

